



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 228 Prot.

Tiranë, më 01/02 / 2022

**V E N D I M**

**Nr. 31, Datë 01 / 02 / 2022**

Bazuar në nenin 33/11, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O N :**

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri, ka shqyrtuar ankesën nr.30 Regj, datë 26.02.2021, të paraqitur nga ankuese L. Gj, kundër Bashkisë Kukës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “ bindjeve politike”. Me vendimin nr. 143, datë 05.08.2021, Komisioneri ka disponuar në lidhje me ankesën, duke vendosur: “*Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses L.Gj, për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kukës, në lidhje me uljen në pagë. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses L. Gj, në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Kukës. Në pikën 3, të këtij vendimi Komisioneri ka vendosur që: “Bashkia Kukës, të marrë masa për shfuqizimin e vendimit nr.37, datë 29.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë “Për dhënien e masës disiplinore” ndaj ankueses.”*

Bashkia Kukës, megjithëse mori dijeni për vendimin e sipërcituar, nuk e informoi Komisionerin në lidhje me masat e marra për zbatimin e vendimit. Në vijim të monitorimit të zbatimit të vendimit, nëpërmjet shkresës me nr.759/2 prot., datë 03.12.2021, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Kukës informacion lidhur me masat e ndërmarra në zbatim të vendimit të Komisionerit. Bashkia Kukës nuk dërgoi asnjë informacion në lidhje me sa më sipër iu kërkua.

Për rrjedhojë, në mungesë të zbatimit të vendimit dhe bazuar në nenin 33, pikat 11, 12, 13, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri me vendimin nr. 11, datë 11.01.2021 vendosi të gjobisë Bashkisë Kukës në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Me shkresën nr. 115/1 prot., datë 14.01.2022, Bashkia Kukës, ka informuar Komisionerin se, në zbatim të vendimit nr.11, datë 11.01.2022 dhe vendimit nr.143, datë 05.08.2021, kishte marrë masa për shfuqizimin e vendimit nr.37, datë 29.03.2021 “Për dhënie mase disiplinore” ndaj punonjësës L.Gj. Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga Bashkia Kukës, rezulton se, me vendimin nr.06, datë 13.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kukës është vendosur : “Shfuqizimi i vendimit nr.37, datë 29.03.2021 “Për dhënie mase disiplinore” ndaj punonjësës L. Gj.”

Rezulton se, Bashkia Kukës ka zbatuar vendimin nr.143, datë 05.08.2021 brenda shtatë ditëve nga vendosja e sanksionit me gjobë sipas vendimit nr.11, datë 11.01.2022 të Komisionerit.

Bazuar në sa më sipër si dhe mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 33/11, i cili përcakton se: “...Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”, Komisioneri arrin në përfundimin se, vendimi nr. 11, datë 11.01.2021 për vendosjen e sanksionit me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj Bashkisë Kukës duhet të shfuqizohet.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Shfuqizimin e vendimit me gjobë Nr. 11, datë 11.01.2022, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Të njoftohen palët për këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**